



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Prishtinë, 08 Nëntor 2021

Njoftimi lidhur me vendosjen e apeleve të paraqitura kundër vendimit të KQZ-së për shpalljen e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve për Kuvende Komunale të mbajtura me datën 17 Tetor 2021.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), brenda afatit ligjor prej 72 orëve ka vendosur lidhur me 352 apele të paraqitura nga kandidatet për anëtarë të Kuvendeve Komunale kundër Vendimit të KQZ-së për shpalljen e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve.

PZAP-i është në proces të dërgimit të kopjeve fizike të vendimeve të gjithë ankuesve, në mënyrë që të njëjtit të shfrytëzojnë të drejtën eventuale të ankimit të këtyre vendimeve në afat prej 24 orësh prej momentit të pranimit të tyre, në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Për më tepër, publiku mund ti qaset Ueb Faqes zyrtare të PZAP-it të hapësira – Statusi i Rastit janë të shënuar të dhënat se cili subjekt, kandidat apo palë tjetër me interes kundër kujt është ankuar dhe pse është ankuar., ndërsa te hapësira Vendimet, mund ti gjeni vendimet e publikuara për secilin rast për te kuptuar se çka është vendosur për secilën ankesë/apel. Numri i statusit të rastit është edhe numri i vendimit të PZAP-it i publikuar në UF e PZAP-it.

Me respekt,